



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:021095

Datë: 08.02.2021

Numri i dokumentit: 01484023

C.nr.1/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Jonuz Bugari**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a.(K.) - Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar N. P., juriste e diplomuar, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurit L. S. K. nga fshati Dobidol, Komuna e Rahovecit, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 365,20 €uro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor, më **21.12.2020**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a.(K.) - Prishtinë.

OBLIGOHET i padituri **L. S. K.**, që në emër të kompensimit të dëmit material ti paguaj shumën prej 365,20 €uro, me kamatë vjetore sipas normës 8 %, e cila do të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi 21.12.2020.

OBLIGOHET i padituri që paditësit t'i paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 20,00 €uro, po ashtu në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësja K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.a.(K.) - Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurit L. S. K., për shkak të kompensimit të dëmit material.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor për datën 21.12.2020, në të cilën është paraqitur përfaqësuesja e autorizuar e paditëses N. P., ndërsa për të paditurin askush ka dëshmi se ka pranuar ftesën i njëjti mirëpo në seancë nuk është paraqitur e mungesën e vet nuk e ka arsyetuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditëses N. P., i ka propozuar gjykatës që seanca e shqyrtimit kryesor të mbahet në mungesë të paditurit pasi që ka prova se i njëjti është ftuar për seancën e sotme mirëpo në seancë nuk është paraqitur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë në vlerë prej 365.20 Euro, dëm që është shkaktuar nga i padituri si pasojë e kryerjes së veprës penale neni 314. Par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i padituri në aktgjykimin P.nr 580/15 të datës 28.08.2017, me të cilin është shpallur fajtorë. Andaj i propozoi gjykatës që pas administrimit të provave padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar si dhe shpenzimet procedurale.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin në aktgjykimin penal P.nr.580/2015, prej datës 28.08.2017, ka bërë shikimin në faturën DGJ15HP04504 e datës 27.01.2015 dhe ka bërë shikimin në faturën e kalkulimit të datës 27.01.2015.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditëses është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.580/2015, prej datës 28.08.2017, vërtetohet se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me kusht.

Me shikimin në shikimin në faturën DGJ15HP04504 e datës 27.01.2015, vërtetohet se vlera totale e borxhit është 365,20 Euro.

Me shikimin në shikimin në faturën e kalkulimit të datës 27.01.2015, vërtetohet se energjia për faturim të shpenzimit të paautorizuar është 807 KWh.

Me nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë se **“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”**, ndërsa me nenin 137 të po këtij ligji, është paraparë se **“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”**.

Në bazë të lartcekurave gjykata ka ardhur në përfundim se është argumentuar fakti se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses në vlerë prej 365,20 Euro, si rezultat i vjedhjes së rrymës, e që është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, Divizioni Penal, P.nr.580/2015, prej datës 28.08.2017, vërtetohet se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me kusht.

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata murr për bazë aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, Divizioni Penal, P.nr.580/2015, prej datës 28.08.2017.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe bazuar në dispozitën e nenit 136 dhe 137 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 143 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, më: 21.12.2020
C.nr.1/2020**

**B. Profesional
Armond Qmega**

**Gjyqtari
Jonuz Bugari**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit – Divizioni Civil në Prishtinë.